[Shqiptarja.com]

Kërko

Të gjitha fjalët Të paktën një fjalë Fjalët ekzakt

DITA E DYTË E VAKSINIMIT NË SHQIPËRI

POP 5 Lajmet më të lexuara të 5 minutave të fundit

1  Spitali i Fierit/ Pronarët e tokave pas takimit me Ramën: Duam çmimin e tregut! Kryeministri na tha që vendi është vendosur (VIDEO)

2  Përfaqësuesi turk: Spitali në Fier 60-70 mln euro! 20-30% e punonjësve do jenë shqiptar! Rama: Paga minimale 40 mijë lekë

3  Ky është shqiptari i ekzekutuar në Athinë pas përplasjes mes bandave

4  60-7 punë

Aktualitet

# Lëviznin me 'Audi A8' të blinduar dhe të armatosur me pistoleta e thika, arrestohen tre fierakët

*Në total u sekuestruan në cilësinë e provës materiale 2 pistoleta, 2 krehra me 24 fishekë, 2 thikat dhe automjeti i blinduar Audi A8.*

RAPORTO! Chat live me Shqiptarja.com

**Redaksia**
20 Dhjetor 2019, 09:31 | Përditesimi i fundit: 20 Dhjetor 2019, 13:49

Share 531 Tweet




**FIER-**Tre persona me rrezikshmëri sipas policisë janë arrestuar në fshatin Çlirim në një makinë të blinduar, e cila është sekuestruar së bashku me 2 armë zjarri, municion luftarak dhe 2 armë të ftohta. Të arrestuarit janë;

*Rudolf Lazëraj 20 vjeç drejtuesi i mjetit*
*Shkëlzen Kajliç 33 vjeç, i dënuar më parë për armëmbajtje pa leje*
*Admir Berisha 35 vjeç*

RAPORTO! Chat live me Shqiptarja.com



LEXO EDHE:

**Spitali i Fierit nga Turqi/ Pronarët: S'japim tokën e kemi burim jetese! Rama: S'diskutohet! Shpronësim sipas ligjit, me familjet marrëveshje (VIDEO)**

Sipas policisë, gjatë kontrollit të ushtruar në fshatin Çlirim, Fier në mjetin e blinduar 'Audi A8', i cili drejtohej nga Rudolf Lazëraj poshtë sediljes së parë të pasagjerit, ku ishte ulur Shkëlzen Kajliç u gjetën dhe sekuestruan 2 armë zjarri tip pistoletë dhe 2 krehra me 24 fishekë.

Gjatë kontrollit personal, 20-vjeçarit Rudolf Lazëraj iu gjet dhe sekuestrua një mjet prerës (thikë), që e kishte në çantën e dorës. Gjithashtu, gjatë kontrollit të ushtruar ndaj 35-vjeçarit Admir Berisha u gjet dhe u sekuestrua një mjet prerës (thikë).

Në total u sekuestruan në cilësinë e provës materiale 2 pistoleta, 2 krehra me 24 fishekë, 2 thikat dhe automjeti i blinduar Audi A8. Materialet i kaluan Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës Parë Fier, për veprat penale "Armëmbajtje pa leje" dhe "Mbajtja pa leje e armëve të ftohta".




*Pistoletat e sekuestruara nga policia*

RAPORTO! Chat live me Shqiptarja.com